



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 862 Prot.

Tiranë, më 21.06.2021

V E N D I M

Nr. 4, datë 15.06.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIMIN E  
BURIMIT UJOR TË Z. ILIR TREBICKA, ME OBJEKT, “NDËRTIMIN  
E STRUKTURAVE ANKORUESE, PORTUALE DHE ISHUVJE  
ARTIFICIALE NË DET”, ME VENDNDODHJE: FSHATI DHËRMI,  
BASHKIA HIMARË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli Kombëtar i Ujqit

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Z. Ilir Trebicka, “Për përdorimin e burimit ujqor” me objekt “Veprimtari ndërtimore në brigje për ndërtimin e Mol-it për ankorimin e skafeve për lojërat e ujqit dhe lëvizjet e turistëve të resortit turistik në det me vendndodhje: Fshati Dhërmi, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë”.
2. Vendodhja e strukturës në det (KRGJSH).

X-466108.807; Y-4447246.422 Z-0; X-466113.336; Y-4447244.302 Z-0;

X-466092.134; Y-4447199.006 Z-0; X-466087.604; Y-4447201.127 Z-0;

3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRACE**



**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**GERTA LUBONJA**